



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Nëntor 2023

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Nëntor 2023

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet për muajin nëntor të vitit 2023)

Reagim i KPK-së për media

Prishtinë, 3 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, për shkak të shpifjeve të bëra në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës, më 2 nëntor 2023, nga kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Adnan Rustemi, më 3 nëntor 2023 bënë këtë reagim, si më poshtë:



Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Këshilli Prokurorial i Kosovës, përmes këtij reagimi publik, shpreh shqetësimin e thellë ndaj shpifjeve dhe fyerjeve të bëra nga deputeti Adnan Rustemi në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ngase i njëjti, duke keqpërdorur besimin e qytetarëve, ka shpifur dhe propozuar iniciativë për shkarkimin e anëtarit të KPK-së, profesorit Agron Beka, duke vënë në lajthitje Komisionin dhe deputetët, pa pasur asnjë argument ligjor, por vetëm me qëllim të denigrimit të figurës së tij dhe me qëllim të realizimit të interesave politike për ndërhyrje në sistemin prokurorial veçanërisht para proceseve të rëndësishme që janë në vazhdim e sipër.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës dhe të nderuar deputetë, Ju njoftojmë se, anëtari i KPK-së, z.Beka, për angazhimin e tij në KPK nuk ka asnjë

vërejtje në ushtrimin e detyrës së tij, asnjë shkelje dhe aq më pak procedurë. I njëjti me punën e tij dhe profesionalizmin e treguar ka ndihmuar dhe po ndihmon sistemin prokurorial dhe KPK-në në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi kushtetuese. Tendenca e djeshme nga deputeti në fjalë, duke mos e ruajtur aspak profesionalizmin, duke iniciuar procedurë për shkarkim në bazë të disa letrave nga disa njerëz të akuzuar tanimë nga prokuroria, që fare nuk kanë të bëjnë me KPK-në dhe duke dashur që t'ia imponojë Kuvendit edhe informatat shpifëse dhe fyese, dëshmon se kjo urrëjtje dhe tendencë është për të ndërhyrë në institucionin e pavarur dhe kushtetues - në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Deklarata e deputetit Rustemi të thëna në Kuvendin e Kosovës se “z.Beka ka keqpërdorur detyrën dhe se ka ndikuar që përmes anëtarit të KPK-së të avancohet dhe se ndaj të njëjtit ka shumë procedura – kallëzime penale dhe civile, të gjitha të mbështetura në provat”, sipas deputetit Rustemi, me qëllim të informimit të drejtë dhe të saktë, Këshilli Prokurorial i Kosovës kërkon nga z.Rrustemi që pretendimet me prova t'i deponojë në organin e akuzës, me qëllim që të dalë e vërteta në pah.

Nëse i njëjti nuk e bënë një veprim të tillë dhe se pretendimet e z.Rrustemi nuk faktohen, atëherë ndaj tij do të ketë reagime ligjore.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, edhe njëherë, potencon se z.Agron Beka ka vepruar në kuadër të autorizimeve të veta si anëtar i KPK-së dhe këtë vlerësim nuk mund ta bëjë askush tjetër përpos organit ku punon dhe vepron. Tendenca për të folur në emër të KPK-së dhe tendencat për t'i zbatuar qëndrimet e keqpërdoruesve të Fakultetit Juridik – UIBM në Mitrovicë janë edhe një dëshmi se po tentohet të merret nën kontroll institucioni më i rëndësishëm kushtetues, i cili është themel për ta ruajtur sigurinë juridike në këtë vend.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 6 nëntor 2023

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurori Armend Zenelaj, mbajti sot takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij komisioni, përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane dhe Zyrës së BE-së në Kosovë dhe udhëheqësit e njësive administrative të KPK-së.

Fillimisht, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative miratuan Draftregulloren për Organizmin e

Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shteti dhe, sipas agjendës së paraparë, diskutuan dhe analizuan përmbajtjen e Draftregullore për Qasje në Dokumente Publike, e cila ka për qëllim të përcaktojë procedurën dhe mënyrat e lejit të qasjes së publikut në dokumentet publike të sistemit prokurorial.



Po ashtu gjatë takimit të sotëm u inkorporuan edhe komentet e partnerëve ndërkombëtarë, komente këto, që do të ndikojnë në ofrimin e qasjes më praktike dhe të bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare.

Në përmbyllje të diskutimeve lidhur me këtë draft, u tha se në takimin e ardhshëm do të arrihet finalizimi dhe i njëjti do të procedohet për miratim në njërën nga takimet e KPK-së.

Mbahet takimi i Komisionit për rishqyrtimin e kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Prishtinë, 8 nëntor 2023

Komisioni për rishqyrtimin e kundërshtimeve të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë mbajti një takim, në të cilin janë shqyrtuar kundërshtimet e kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.



Me këtë rast, Komisioni për Rishqyrtim ka vendosur lidhur me kundërshtimet e kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe raportin lidhur me këto kundërshtime do ta dërgojë në takimin e radhës së Këshillit Prokurorial.

Gjatë këtij takimi ishin të pranishëm përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe të EULEX-it.

Finalizohet Draftregullorja për Qasje në Dokumente Publike të Sistemit Prokurorial

Prishtinë, 9 nëntor 2023

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga z.Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e komisionit, përfaqësuesja e Ambasadës Amerikane dhe përfaqësuesi i Zyrës së BE-së në Prishtinë.

Pas diskutimeve të zhvilluara gjatë ditës së sotme, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative përmbyllën punën për hartimin e draftit të Rregullores për Qasje në Dokumente Publike të Sistemit Prokurorial, duke theksuar se ky akt nënligjor është një ndër dokumentet më të rëndësishme për zbatimin e transparencës publike të Këshillit Prokurorial dhe Prokurorit të Shtetit.



Në përfundim të takimit, kryesuesi i këtij komisioni, shprehu falënderim për kontributin e partnerëve ndërkombëtarë në hartimin e këtij akti, i cili është hartuar në përpunje me ligjin përkatës dhe aktet e tjera ligjore, si dhe bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira të qasjes në dokumentet publike.

Konfirmohen listat e kandidatëve për pozitën e kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 17 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), sipas agjendës së paraparë, ka mbajtur takimin e 236-të me radhë, të

jashtëzakonshëm, i cili është udhëhequr nga Zëvendëskryesuesi Veton Shabani.

Fillimisht anëtarët e KPK-së trajtuan kundërshtimin e prokurores Fitore Sadikaj lidhur me moskonfirmimin e statusit të kandidatit për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë. Pas refuzimit të kundërshtimit, anëtarët e KPK-së miratuan listën përfundimtare me kandidatin Zejnullah Gashi për pozitën e lartcekur.



Tutje, KPK-ja miratoi listën prej 4 kandidatësh për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si në vijim: Blerim Isufaj, Valdet Gashi, Atdhe Dema dhe Naim Abazi.

Zëvendëskryesuesi i KPK-së merr pjesë në konferencën “Ditët e Gjyqësorit”

Prishtinë, 17 nëntor 2023

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Veton Shabani, ka marrë pjesë në aktivitetin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës “Ditët e Gjyqësorit”.

Gjatë fjalës së tij, z.Shabani vlerësoi lart këtë organizim, i cili dëshmon seriozitetin, përkushtimin dhe profesionalizmin e sistemit gjyqësor.



Tutje, z. Shabani potencoi bashkëpunimin e mirëfilltë në mes të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor, jo vetëm të bazuar në obligimet ligjore, por edhe në vullnetin e përbashkët për luftimin e kriminalitetit,

krijimin e një ambienti të sigurt për qytetarët dhe ngritjen e besimit të publikut.

Në fund, z.Shabani, shprehu përkushtimin e tij për vazhdimin e punës drejt fuqizimit të performancës së sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor, duke zhvilluar hetime më cilësore, aktakuza kualitative dhe dënime gjyqësore të drejta e meritore, duke pasur gjithmonë në vëmendje misionin tonë, i cili në fokus ka qytetarin e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, priti në takim Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane, Erin Cox dhe Zyrtaren e Lartë Ligjore në OPDAT në Ambasadën Amerikane, Benina Kusari

Prishtinë, 22 nëntor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka pritur në takim Këshilltarin Rezident Ligjor në Ambasadën Amerikane në Kosovë, Erin Cox dhe Zyrtaren e Lartë Ligjore në OPDAT, Benina Kusari.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi për jetësimin e iniciativave të përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit dypalësh për forcimin e rendit dhe zbatimin e ligjit në Kosovë.



Me këtë rast, Kryesuesi Maloku, falënderoi Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke shprehur vullnetin dhe përkushtimin e madh për të zhvilluar partneritetin e përbashkët në fushat përkatëse që ndërlidhen me sistemin prokurorial në Republikën e Kosovës, kurse Këshilltari Rezident Ligjor, Cox, vlerësoi bashkëpunimin e deritashëm me KPK-në.

Në përfundim të takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën vullnetin dhe gatishmërinë e thellimit të mëtejshëm të bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe Ambasadës Amerikane.

Mbahet punëtori dyditore për hartimin e projektit të Strategjisë për komunikim publik të sistemit prokurorial për vitet 2024-2026

Prishtinë, 22 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), në bashkëpunim dhe me mbështetje të Misionit të OSBE-së dhe Projektit EKOJUST, kanë organizuar një punëtori dyditore për hartimin e projektit të Strategjisë për komunikim publik, në të cilën sot morën pjesë Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, Prokurorja në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Sevdije Morina, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Misionit të OSBE-së, Projektit EKOJUST, Akademisë së Drejtësisë, Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe të organizatave të shoqërisë civile.



Në hapje të sesionit të parë, Kryesuesi Maloku, theksoi se, ndër qëllimet kryesore të hartimit të këtij dokumenti strategjik është rritja e besimit të publikut në sistemin prokurorial të Kosovës, sepse kjo përbën një mundësi reale të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, të shoqërisë civile dhe të mediave në realizimin e misioneve përkatëse publike, si dhe kontribuon ndjeshëm në rritjen e llogaridhënies institucionale të autoriteteve dhe zyrtarëve, që ushtrojnë funksione publike, duke zhvilluar më tej transparencën publike të institucioneve dhe përgjithësisht një shoqëri të denjë demokratike.



Më tej, përfaqësuesit e projektit EUKOJUST prezantuan aspektet metodologjike të hartimit të projektstrategjisë sipas standardeve dhe praktikave më të mira, ndërsa më pas pjesëmarrësit së bashku me anëtarët e grupit punës diskutuan për qasjen e mekanizmave të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, avancimin e bashkëpunimit me mediat dhe shoqërinë civile, si dhe për rritjen e komunikimit prokativ publik.

Kjo punëtori do të vazhdojë edhe gjatë ditës së nesërme, me ç'rast do të diskutohet për përdorimin e mediave sociale dhe mjeteve online për të përmirësuar komunikimin me mediat dhe publikun dhe për përditësimin e planit të veprimit, i cili do të zhvillohet përmes një procesi gjithëpërfshirës të përfaqësuesve të sistemit prokurorial, OSBE-së dhe EUKOJUST-it, Ambasadës Amerikane, Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe shoqërisë civile.

Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 23 nëntor 2023

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë edhe përfaqësuesit e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

Me këtë rast, anëtarët e Komisionit për Çështje Normative miratuan draftin e Rregullores për qasje në dokumente publike të sistemit prokurorial, e cila pas vënies në dëgjim publik do të procedohet për miratim në njërin nga takimet e KPK-së, si dhe formuan Grupin e punës për hartimin e draftit të Rregullores për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV).



Gjatë takimit është diskutuar edhe për draftin e Rregullores për Themelimin e Zyrës për Rikthimin e Aseteve, për të cilën është thënë se do të jetë në harmoni të plotë me standardet dhe praktikën e BE-së, me ç'rast përfaqësuesit e OSBE-së, theksuan rolin dhe rëndësinë e madhe që ka themelimi i kësaj zyre për shtetin e Kosovës.

Intervistohen kandidatët për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës

Prishtinë, 24 nëntor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës organizoi sot procesin e intervistimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.



Panelët vlerësuese për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të cilat përbëhet nga pesë anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kryesohen nga Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, intervistuan pesë kandidatë, të cilët aplikuan dhe janë konfirmuar për të hyrë në procedurat e mëtejshme lidhur me këto dy pozita në sistemin prokurorial.

Kandidatët për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës janë

prokurorët, si vijon: Atdhe Dema, Blerim Isufaj, Naim Abazi dhe Valdet Gashi, kurse kandidat për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë është Zejnulla Gashi.

Procesi i intervistimit të kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë është monitoruar nga përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Misionit për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX), Zyrës së BE-së në Kosovë, Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST) dhe shoqërisë civile.

KPK-ja do t'i mbajë mediat dhe opinionin publik të informuar në vazhdimësi lidhur procedurat dhe procesin e mëtejshëm të përzgjedhjes së këtyre pozitave në sistemin prokurorial.

Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, uron bashkëkombësit me rastin e Festës së Flamurit Kombëtar

Prishtinë, 28 nëntor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, ka uruar bashkëkombësit me rastin e 28 Nëntorit - Ditës së Flamurit Kombëtar, me ç'rast në urimin e tij thuhet:

Të nderuar bashkëkombës,

Dita e Flamurit Kombëtar shënon piedestalin më të lartë të përkushtimit atdhetar dhe sakrificës patriotike të gjeneratave të tëra dhe përherë na sjell ndërmend nderimin dhe respektin madhështor që do t'u bëjmë idealeve dhe veprave të dëshmorëve dhe të gjithë të rënëve në periudhat e ndryshme për lirinë kombëtare.



Rrjedhimisht, Dita e Flamurit Kombëtar - 28 Nëntori, është dhe mbetet ndër ne udhërrëfyese e denjë dhe transmetuese e fuqishme e ndjenjave tona për të lartësuar në çdo kohë dhe në çdo vend vlerat e lirisë sonë dhe vlerat universale të saj, që u arritën me përpjekje dhe sakrificë të panumërta.

Më këtë rast, në emër të Këshillit Prokurorial dhe në emrin tim personal ua përcjell me ngrohtësinë më të madhe urimet për këtë ditë historike dhe uroj që vitet dhe deceniet e ardhshme të jenë të ndritura për kombin shqiptar!

Andaj, urime Ditën e Flamurit dhe festat e tjera të Nëntorit, të cilat janë pasardhëse të sublimimit më të shndritshëm të synimeve të gjata për liri, demokraci, pavarësi dhe dinjitet kombëtar!

Me respekt,

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës,

Jetish Maloku

KPK zgjodhi Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit dhe Drejtorin e Njësitit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë

Prishtinë, 30 nëntor 2023

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi z. Jetish Maloku, mbajti takimin e 237-të me radhë, me ç'rast janë diskutuar dhe miratuar pikat sipas rendit të paraparë të ditës.

Gjatë takimit të sotëm, KPK zgjodhi z.Sami Istrefin në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së (SKPK) dhe znj.Arta Kelmendi në pozitën e Drejtoreshës së Njësitit për Shqyrtimin e Përfformancës së Prokurorisë (NJSHPP).



KPK-ja themeloi Panelin Hetimor për rastin e një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe aprovoi Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit të KPK-së, të datës 13 tetor 2023, lidhur me tejkalimin nga 1% në kuotën 2.05 % për pagesa të kujdestarisë së prokurorëve.

Gjithashtu, KPK aprovoi rekomandimin e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve për zgjatjen e trajnimit fillestar për dy prokurorë, të cilat kanë qenë në pushim të lehonisë dhe aprovoi kërkesën e Komisionit për Administrimin e Prokurorive për themelimin e grupit punues të përdoruesve për sistemin prokurorial në kuadër të projektit të Sistemit Menaxhues Informativ të Lëndëve (SMIL).

Anëtarët e Këshillit miratuan Raportin e Komisionit për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë dhe trajtuan kundërshtimet përkatëse, me ç'rast aprovuan pjesërisht të njëjtat dhe miratuan rekomandimin e këtij komisioni që kjo çështje të kthehet tek Paneli Vlerësues për rishikim.

Po në këtë takim, KPK miratoi Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve për procesin e avancimit të tre prokurorëve në Prokurorinë e Apelit dhe trajtoi kundërshtimet e paraqitura, me ç'rast në Prokurorinë e Apelit janë avancuar znj.Sebahate Sinani nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, z.Illaz Beqiri nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe znj.Nazan Shero nga Prokuroria Themelore në Prizren.

KPK miratoi edhe Raportin për Vlerësimin e Performancës së njëmbëdhjetë prokurorëve me mandat të përhershëm, si dhe mbajti një seancë dëgjimore disiplinore për rastin e një prokurori në

Prokurorinë Themelore në Prishtinë, kurse vendimi do të nxjerrët siç parashihet me Ligj.

Këshilli përditësoi listën e prokurorëve me anëtarë të rinj që shërbejnë në panelet hetimore për shkak të skadimit të mandatit të anëtarëve të mëparshëm, kurse në përfundim të takimit miratoi edhe njoftimin për pensionimin e dy prokurorëve gjatë muajit dhjetor 2023 dhe mori vendim për të dërguar propozimet tek Presidentja e vendit për t'i liruar nga detyra me rastin e arritjes së moshës së pensionimit të tyre.